



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
DREJTORIA RAJONALE E TRASHËGIMISË KULTURORE GJIROKASTËR Nr.

Nr. 648 Prot.

Gjirokastër më: 08.10.2024

Lënda: Kërkesë për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike të datës 14.10.2024

**AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK**

**Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë**

Në zbatim të Kreut II pika 13 e VKM nr. 425, datë 27.5.2020 “Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore” i ndryshuar, dhe Lidhjes 1, Shtojca 1 e Udhëzimit të Ministrit të Kulturës nr. 269, datë 11.08.2020, i ndryshuar, bashkëlidhur po ju dërgojmë për publikim “FORMULARI I NJOFTIMIT TË KONKURRIMIT PUBLIK”.

Njoftimi ju dërgohet edhe në format elektronik (CD) si dhe në adresën zyrtare të emailit – [info@app.gov.al](mailto:info@app.gov.al).

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**DREJTOR**

**Ardis DUKA**



Adresa: Rruga Dr.Vasil Laboviti Nr. 3, Lagjia Varosh, Gjirokastër, Shqipëri.

Tel: +355 84 26 9001

E-mail: [drtkgjirokaster@meki.gov.al](mailto:drtkgjirokaster@meki.gov.al)



## FORMULARI I NJOFTIMIT TË KONKURRIMIT PUBLIK

1. Institucioni/Autoriteti Kontraktor – **Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Gjirokastër**, njofton subjektet e interesuara të licencuara në zbatim, në pasuritë kulturore të marrin pjesë me ofertat e tyre publike në konkurrimin publik të shpallur nga ky institucion.
2. Emërtimin dhe vendndodhjen e objektit: **“RESTAURIMI I KISHËS SË SHPËRFYTYRIMIT, CATISTË, GJIROKASTËR”**, Monument Kulture i kategorisë së I-rë.
3. Llojin e punës: **“RESTAURIMI I KISHËS SË SHPËRFYTYRIMIT, CATISTË, GJIROKASTËR”**
4. Fondi limit i procedurës së konkurrimin **1.680.930 (një milionë e gjashtëqint e tetëdhjetë mijë e nëntëqint e tridhjetë) lekë pa TVSH**, sipas preventivit të punimeve të miratuar në KKTKM.
5. Afati i realizimit të kontratës **60 (gjashtëdhjetë) ditë**, nga data e lidhjes së kontratës.
6. Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është jo më pak se 8 ditë nga publikimi i këtij njoftimi në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit Kontraktor, përkatësisht data **23.10.2024 ora 09:00**, në zyrën e protokollit të institucionit, me Adresë, Rr. “Dr. Vasil Laboviti”, Nr.3, Lagjia Varosh, Gjirokastër, Shqipëri. Ofertat e paraqitura pas këtij afati do të refuzohen.
7. Afati dhe mënyra për tërheqjen e dokumenteve të konkurrimin publik: Kandidatët e interesuar mund të aksesojnë dokumentet standarde të konkurrimin publik në faqen zyrtare të Autoritetit Kontraktor: [www.drtdkjgjirokaster.com](http://www.drtdkjgjirokaster.com), në Rubrikën “Faqja Kryesore/Njoftime”.
8. Ofertat duhet të shoqërohen nga dokumente ligjorë dhe administrative, origjinalë ose kopje të noterizuara, si provë e plotësimit të kërkesave kualifikuese të përcaktuara në dokumentet standarde, të miratuara për këtë qëllim.
9. Hapja e ofertave nga Njësia e Vlerësimit, do të jetë në datë **23.10.2024, ora 15:00**, në Autoritetin Kontraktor/ Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Gjirokastër, kati II, Zyra e Specialistëve të AAAMTK-së., dhe do të shqyrtohen brenda afatit prej 7- ditësh nga data e hapjes së tyre.
10. Ofertuesit apo Përfaqësues të autorizuar me shkrim të tyre mund të jenë të pranishëm në datën, orën dhe vendin e hapjes së ofertave.



Adresa: Rruga Dr.Vasil Laboviti Nr. 3, Lagjia Varosh, Gjirokastër, Shqipëri.

Tel: +355 84 26 9001

E-mail: [drtdkjgjirokaster@meki.gov.al](mailto:drtdkjgjirokaster@meki.gov.al)

